



## Udhëzimi 29

### Prokurimi publik

Shtator 2016

# Zbulimi dhe korigjimi i gabimeve të zakonshme në prokurimin publik

#### PËRMBAJTJA

- [Çfarë është gabimi në prokurimin publik?](#)
- [Si zbulohen gabimet në prokurimin publik?](#)
- [Klasifikimi i gabimeve dhe ndikimi i tyre në rezultatet e procedurës së prokurimit publik](#)
- [Cilat janë gabimet më të zakonshme në prokurimin publik dhe si duhet të korigjohen ato?](#)
- [Informacion i mëtejshëm](#)

Autorizuar për botim nga Karen Hill, Drejtuese e Programit të SIGMA-s.

## Çfarë është gabimi në prokurimin publik?

Për qëllimet e këtij Udhëzimi, gabimet në prokurimin publik përshkruhen si shkelje e rregullave (parimeve) të prokurimit publik, pa marrë parasysh fazën e procedurës ose të pasojave të sa për buxhetin publik.

Gabimet në prokurimin publik mund të ndodhin:

- **Para** fillimit formal të një procedure të prokurimit në fazën e planifikimit të një prokurimi specifik: për shembull, gjatë procesit të vlerësimit të vlerës së prokurimit ose të marrjes së një vendimi në lidhje me zbatimin e një procedure të veçantë. Vendimet e marra para fillimit të procedurës formale të prokurimit padyshim kanë ndikim në rrjedhën e veprimit të ndërmarrë nga autoriteti kontraktor.
- **Gjatë procedurës së prokurimit:** për shembull, vlerësimi i gabuar i kualifikimeve të operatorit ekonomik, keqpërdorim i rregullave për përzgjedhjen e operatorëve ekonomikë, apo vlerësimi i gabuar i ofertave.
- **Pasi** procedura është realizuar dhe kontrata është dhënë: për shembull, mospublikimi i Njoftimit të Dhënies së Kontratës, modifikimi i paligjshëm i një kontrate të lidhur tashmë, ose dhënia e punëve ose shërbimeve shtesë pa kushte të përmbushura.

## Si zbulohen gabimet në prokurimin publik?

Gabimet në prokurimin publik zakonisht zbulohen dhe trajtohen me anë të mekanizmave (procedurave) të mëposhtme:

- **Procedurat e shqyrtimit** të shkaktuara nga ankesat e operatorëve ekonomikë kundër vendimeve të autoriteteve kontraktore. Ankesat e tilla mund të iniciojnë shqyrtimin nga gjykata ose nga një organ i pavarur shqyrtues.
- **Auditimi** i kryer nga zyrat shtetërore të auditimit (auditimi i jashtëm) dhe auditimet e kryera nga një njësi e specializuar brenda organizatës (auditimet e brendshme).
- **Verifikimet** (inspektimet) e kryera nga një organ i specializuar: për shembull, zyra e prokurimit publik, ministria e financave, ose një organ tjetër kompetent i mbikëqyrjes në bazë të kërkesës, në bazë të ankesave të palëve përkatëse, ose *kryesisht* me iniciativën e tyre.
- **Kontrollet** e kryera nga inspektimet e tjera administrative ose financiare dhe agjencitë e zbatimit të ligjit.

## Klasifikimi i gabimeve dhe ndikimi i tyre në rezultatet e procedurës së prokurimit publik

Llojet e ndryshme të gabimeve që ndodhin në procesin e prokurimit publik, mund të identifikohen në varësi të kriterëve të aplikuara. Për qëllimet e këtij Udhëzimi, dallimi në mes të gabimeve ka qenë i bazuar në kriterin e **ndikimit të gabimit në rezultatet e procedurës së prokurimit**. Në këtë mënyrë, gabimet mund të klasifikohen ose si (1) gabime **të rëndësishme** (materiale) ose (2) gabime **të parëndësishme** (të vogla).

Audituesit e Gjykatës Evropiane të Audituesve (GjEA) bëjnë të njëjtin dallim. Në broshurën e saj me titull "*Përkufizimi dhe trajtimi i gabimeve të DAS-së*"<sup>1</sup>, GjEA tregon se gabimet janë rëndësishme për

<sup>1</sup> DAS është një akronim Francez që përdoret për deklaratën e sigurimit (në frëngjisht: *Déclaration d'Assurance*). Ai i referohet opinionit vjetor që nxjerr Gjykata Evropiane e Audituesve, në përputhje me nenin 287 (1) të Traktatit për Funkcionimin e Bashkimit Evropian (BE), në lidhje me të gjitha të ardhurat dhe shpenzimet e BE-së. [http://www.eca.europa.eu/Lists/ECADocuments/DAS\\_ERRORS/DAS\\_ERRORS\\_EN.PDF](http://www.eca.europa.eu/Lists/ECADocuments/DAS_ERRORS/DAS_ERRORS_EN.PDF)

qëllimet e DAS-së "në qoftë se ato do të ndikojnë në mënyrë të arsyeshme në vendimet e të adresuarit të opinionit të auditimit, veçmas ose nëse bashkohen me gabime të tjera". Sipas politikës së GjEA-s, nuk është realiste të supozohet se në praktikë nuk ndodhin gabime, dhe "rrjedhimisht, një shkallë e caktuar tolerance duhet të konsiderohet e pranueshme në lidhje me nivelin e duhur të saktësisë".

Për qëllimet e këtij Udhëzimi:

- **Gabimet e rëndësishme (materiale)** janë ato që **kanë ndikim në rezultatet e procedurës së veçantë të prokurimit**. Me fjalë të tjera, rezultatet e procedurës do të kishin qenë ndryshe nëse gabimi nuk do të ishte kryer. Për shembull, refuzimi i pabazuar, për arsye formale, i ofertës më të mirë të paraqitur në procedurë ka padyshim ndikim në rezultatet e procedurës, pasi zgjidhet oferta më pak e favorshme apo thjesht më e shtrenjtë.
- **Gabimet e parëndësishme (të vogla)** janë të gjitha gabimet e tjera që ndodhin në zbatimin e rregullave të prokurimit, të cilat **nuk ndikojnë në rezultatet e procedurës**. Për shembull, e njëjta ofertë do të ishte përzgjedhur si më e mira, edhe në qoftë se nuk do ishte bërë asnjë gabim, ose operatori ekonomik që është refuzuar gabimisht, nuk do të ishte fituesi i procedurës.

Në kontekstin e prokurimit publik, mospublikimi i **Njoftimit të Kontratës** (ftesës për ofertë), në qoftë se një njoftim i tillë kërkohet me ligj, dhe mospublikimi apo publikimi i vonuar i **Njoftimit të Dhënies së Kontratës** janë të dyja shkelje të dispozitave të veçanta të prokurimit publik. Megjithatë, ato kanë pasoja të ndryshme për prokurimin në fjalë. Në mënyrë të ngjashme, autoriteti kontraktor që nuk i ka kërkuar ofertuesit që të paraqesë dokumentet që mungojnë ose që janë të paplota, ndërkohë që ka kërkuar dokumente të tilla nga pjesëmarrësit e tjerë, ka shkelur rregullat formale që përcaktojnë se duhet bërë një kërkesë e tillë. Megjithatë, nëse oferta e dorëzuar nga ofertuesit nuk ka pasur ndonjë shans për të fituar kontratën pasi çmimi ka qenë shumë i lartë, atëherë një shkelje e tillë ka qenë e parëndësishme. Arsyeja për klasifikimin e këtij gabimi si të parëndësishëm është se rezultatet e procedurës do të kishin mbetur të njëjta, edhe në qoftë se autoriteti kontraktor do të kishte vepruar në përputhje të plotë me detyrimet e tij.

Megjithatë, **dallimi ndërmjet gabimeve të rëndësishme dhe të parëndësishme** nuk është i qartë, dhe si i tillë kërkon një qasje rast pas rasti dhe një vlerësim të kujdesshëm të rrethanave të veçanta. Gabimet e parëndësishme, madje edhe në qoftë se ato nuk kanë ndonjë ndikim në rezultatin e procedurës, duhet të zbulohen dhe të sillen në vëmendjen e autoritetit kontraktor në fjalë si për arsye edukative ashtu edhe parandaluese.

Ky Udhëzim paraqet një listë të gabimeve më të zakonshme në prokurimin publik dhe jep një shpjegim të shkurtër të rregullave përkatëse të shkelura, metodat e zbulimit, pasojat e shkeljes, si dhe mënyrat e largimit (korrigjim). Lista e paraqitur më poshtë nuk është menduar të jetë një listë e plotë e gabimeve të mundshme, të cilat mund të ndryshojnë ndërmjet legjislacioneve kombëtare, pasi rregullat mund të jenë të ndryshme. Përkundrazi, lista është kufizuar në gabimet më universale. Duhet mbajtur parasysh se sa më të komplikuar dhe më përshtues të jenë rregullat në fuqi, aq më shumë ka të ngjarë që shkeljet e këtyre rregullave do të ndodhin herët a vonë.

Gabimet e treguara më poshtë janë grupuar sipas fazave të procesit të prokurimit.

## Cilat janë gabimet më të zakonshme në prokurimin publik dhe si duhet të korrighohen ato?

### 1. Gabimet në lidhje me planifikimin, përgatitjen dhe nisjen e procedurës

#### a) Mosaplikimi i rregullave të prokurimit

Rregullat e prokurimit publik përcaktojnë kategoritë e institucioneve, organeve apo personave (autoriteteve kontraktore) që janë të detyruar të ndjekin rregulla specifike gjatë dhënies së kontratave publike. Nëse autoriteti/subjekti kontraktor lidh një kontratë pa zbatuar rregullat që duhet të ndiqen, ai shkel rregullat e prokurimit. Kjo lloj shkelje mund të ndodhë, për shembull, në situatat e mëposhtme:

- Autoriteti kontraktor jep direkt një kontratë që duhet të lidhet pas një procedure transparente dhe konkurruese të një kontraktori të veçantë.
- Autoriteti kontraktor vepron në mënyrë të paligjshme duke mos zbatuar rregullat e prokurimit, duke u mbështetur në një përjashtim të veçantë nga rregullat e prokurimit, kur, në fakt, nuk janë përmbushur plotësisht kushtet për moszbatimin e këtyre rregullave. Për shembull, autoriteti kontraktor pretendon se ka ndodhur një situatë urgjente që është jashtë kontrollit të tij, kur në fakt kjo nuk ka ndodhur.
- Herë pas here, ka edhe raste kur autoriteti kontraktor lidh kontratën duke ndjekur një procedurë që mund të jetë në vetvete transparente dhe konkurruese, por nuk është procedura që kërkohet sipas ligjit të prokurimit. Për shembull, publikohet ftesa për ofertë, por jo siç kërkohet me ligj, të tillë si publikimi në nivel kombëtar apo lokal në vend që të botohet në *Gazetën Zyrtare të BE-së (GZBE)*.

**Moszbatimi i rregullave të prokurimit të kërkuara nga ligji i prokurimit është një nga shkeljet më të rënda të rregullave të prokurimit.** Kjo ndodh veçanërisht kur, si pasojë e moszbatimit të këtyre rregullave të prokurimit, kontrata në fjalë i jepet direkt një kontraktori të caktuar, pa u dhënë operatorëve të tjerë ekonomikë mundësinë për të shprehur interesin e tyre. Jo vetëm që ky moszbatim i rregullave është kundër parimeve themelore të prokurimit publik, por ai mund të jetë i dëmshëm për financat publike. Kjo mund të rezultojë në pagimin më shumë nga ana e autoritetit kontraktor për punët, furnizimet apo shërbimet se sa ai do të kishte paguar nëse do të ishte zbatuar procedura konkurruese dhe transparente.

**Ky lloj gabimi mund të rregullohet vetëm duke e shpallur kontratën të pavlefshme, nëse kontrata është lidhur tashmë (në përputhje me dispozitat e Direktivës së Mjeteve Juridike<sup>2</sup>), dhe duke nisur një procedurë të re konkurruese të prokurimit.**

#### b) Zgjedhja e gabuar e procedurës së prokurimit

Sipas rregullave të prokurimit të BE-së të përcaktuara nga Direktiva,<sup>3</sup> ka dy procedura themelore të dhënies së kontratës: procedurat e hapura dhe procedurat e kufizuara. Këto procedura trajtohen si procedura "standarde", që do të thotë se ato mund të aplikohen gjithmonë, dhe zgjedhja se cila procedurë të aplikohet i është lënë autoritetit kontraktor.

Të gjitha procedurat e tjera mund të zbatohen vetëm në rrethana të veçanta, të cilat janë të përcaktuara në mënyrë rigorozë nga direktivat përkatëse të prokurimit.

<sup>2</sup> Direktiva 2007/66/KE që ndryshon Direktivat e Këshillit 89/665/KEE dhe 92/13/KEE në lidhje me përmirësimin e efektivitetit të procedurave të shqyrtimit në funksion të dhënies së kontratave publike, 11 dhjetor 2007, e ndryshuar

<sup>3</sup> Direktiva 2014/24/BE për prokurimet publike dhe shfuqizimin e Direktivës 2004/18/KE, 26 shkurt 2014.

Sipas Direktivës së Shërbimeve,<sup>4</sup> subjektet kontraktore mund të zgjedhin lirisht në mes të procedurave të hapura, të kufizuara dhe me negociim, me kusht që të bëhet ftesë për konkurrim. Për informacion të mëtejshëm mbi rrethanat në të cilat mund të zbatohen procedurat e ndryshme shih Udhëzimin nr. 10 të SIGMA-s për Prokurimin publik, *Procedurat e prokurimit publik*. Autoriteti kontraktor që nuk respekton rregullat përkatëse që kanë të bëjnë zgjedhjen e duhur të procedurës së dhënies, shkel rregullat e prokurimit publik, në mënyrë të veçantë në qoftë se ai jep një kontratë të drejtpërdrejtë pa ndonjë ftesë për konkurrim.

**Ashtu si në rastin e diskutuar në pikën 1 a) më sipër në lidhje me moszbatimin e rregullave të prokurimit, shkelja në lidhje me zgjedhjen e gabuar të procedurës së prokurimit mund të rregullohet vetëm me shpalljen e kontratës në fjalë si kontratë e pavlefshme (kur kontrata është dhënë tashmë) dhe nisjen e një procedure të re konkurruese të prokurimit.**

### **c) Keqpërdorimi i rregullave që lidhen me vlerësimin e vlerës së prokurimit**

Aplikimi i rregullave të BE-së dhe i atyre kombëtare për prokurimin publik varet zakonisht nga vlera e kontratës në fjalë. Për shembull, direktivat e BE-së zbatohen vetëm për të kontraktuar vlerat që tejkalojnë kufijtë e veçantë financiarë. Për llogaritjen e vlerës së kontratave publike zbatohet një numër parimesh të përgjithshme, si dhe rregulla më të detajuara. Shkelja e rregullave të prokurimit ndodh nëse autoriteti kontraktor:

- **Vlerëson më ulët vlerën e kontratës** në mënyrë që të shmangë zbatimin e rregullave të caktuara; rrjedhimisht, në kontekstin e prokurimit të BE-së, kontrata shpallet vetëm në nivel kombëtar (ose nuk shpallet fare), duke kufizuar ndjeshëm aksesin e kompanive të huaja në informacionin në lidhje me mundësinë e tenderimit;
- **Ndan artificialisht kontratën** në pjesë më të vogla dhe si pasojë zbaton procedura më pak transparente dhe më pak konkurruese; ndarja e një kontrate në pjesë më të vogla inkurajohet si një mjet për të rritur shanset e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme. Ndarja e një kontrate është e pranueshme, nëse ajo nuk bëhet me qëllim për të shmangur kërkesën për zbatimin e rregullave përkatëse;

### **Rast studimor**

Autoriteti kontraktor ka dhënë drejtpërdrejt një kontratë për zhvillimin e një sistemi të ri të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TIK), (e cila është referuar si versioni "provë" ose "test"). Vlera e parashikuar e kontratës ishte nën kufirin financiar kombëtar prej 14 000 Euro, dhe kështu që nuk u publikua Njoftimi i Kontratës. Autoriteti kontraktor nuk përcaktoi në specifikimin e tenderit apo në kushtet e kontratës se të drejtat e autorit në lidhje me softuerin duhej të transferoheshin nga ofertuesi i suksesshëm tek autoriteti kontraktor. Për këtë arsye, ofertuesi i suksesshëm, kompania X, mbajti të drejtat e autorit të softuerit. Më pas, autoriteti kontraktor i dha kompanisë X një seri kontratash të tjera që kishin të bënin me modernizimin dhe zhvillimin e softuerit. Ajo ia dha kontratat shtesë direkt kompanisë X pa asnjë konkurrim. Autoriteti kontraktor pohoi se lejohej dhënia e kontratave shtesë në këtë mënyrë për shkak të Kompania X kishte të drejta ekskluzive (të drejtat e autorit) në lidhje me zhvillimin e mëtejshëm të sistemit të TI-së. Në këtë mënyrë, autoriteti kontraktor filloi me një kontratë me vlerë shumë modeste dhe pastaj ia besoi të njëjtës ndërmarrje, pa konkurs, ofrimin e shërbimeve me vlerë të kombinuar prej 18 milionë Euro.

- **Nuk agregon mallrat, shërbimet dhe punët identike ose të ngjashme** që do të jepen në një periudhë të caktuar dhe zbaton procedura më pak transparente dhe më pak konkurruese, ndërkohë që duhet të zbatojë rregullat që janë të zbatueshme për vlerën totale të të gjitha pjesëve të kombinuara.

<sup>4</sup> Direktiva 2014/25/BE për prokurimet nga subjektet në sektorin e ujit, energjisë, transportit dhe sektorëve të shërbimeve postare dhe shfuqizimin e Direktivës 2004/17/KE, 26 shkurt 2014.

Dispozitat e agregimit kërkojnë që kur ka një numër kontratash të ngjashme, ku secila prej të cilave mund të jetë nën një kufi të caktuar financiar, ato duhet të merren parasysh të gjitha, kur përlogaritet vlera e kontratës. Dispozitat e agregimit shprehen se kur vlera e përgjithshme e kontratave të ngjashme tejkalon kufirin financiar, atëherë rregullat e prokurimit duhet të zbatohen për kontratat që, në qoftë se merren veçmas, nuk arrijnë kufirin financiar. Nëse autoriteti kontraktor vendos ta japë kontratën në pjesë, atëherë ai duhet të marrë parasysh vlerën e pjesëve përkatëse dhe të zbatojë dispozitat (procedurat) që janë të rëndësishme për vlerën e kontratës të marrë si një e tërë. **Shkelja e rregullave në lidhje me përlogaritjen e vlerës së kontratës ose ndarjen artificiale të kontratave përbën shkelje të konsiderueshme, veçanërisht nëse kjo rezulton në zbatimin e procedurave jo transparente dhe jo konkurruese (siç është rasti i dhënies së drejtpërdrejtë të kontratës).**

#### Rast studimor

Autoriteti kontraktor ka dhënë katër kontrata për punë të ngjashme për ndërtimin e sistemit të kanalizimeve. Vlerat e kontratave përkatëse ishin: (1) 1 625 649 Euro, (2) 951 368 Euro, (3) 1 360 502 Euro, dhe (4) 1 49 807 Euro. Vlera totale e të gjitha loteve arriti në 5 428 326 Euro. Në përputhje me rregullat e BE-së, të gjitha lotet duhet të shpallen në *GZBE*, edhe nëse jepen në procedura të veçanta (siç ishte rasti këtu), pasi vlera e akumuluar e prokurimit tejkalon pragun e BE-së prej 5 225 000 Euro. Megjithatë, autoriteti kontraktor aplikoi rregullat e prokurimit publik sikur çdo lot të kishte qenë objekt i një prokurimi krejtësisht të ndryshëm dhe nuk bëri publikimin e Njoftimit të Kontratës në *GZBE*, duke shkelur rregullat e lartpërmendura për agregimin.

**Ashtu si në rastin e dhënies së drejtpërdrejtë të kontratave, shkelja e ndarjes së kontratave artificialisht në vend të aplikimit të një procedure transparente dhe konkurruese mund të rregullohet vetëm duke anuluar procedurën e prokurimit, nëse kontrata nuk është nënshkruar ende, ose, në qoftë se ajo është lidhur tashmë, duke e deklaruar kontratën të pavlefshme.**

Për informacion të mëtejshëm mbi rregullat për llogaritjen e vlerës së kontratës shih Udhëzimin nr. 5 të SIGMA-s për Prokurimin publik, *Të kuptuarit e kufijve monetarë të BE-së*.

#### d) Përshkrimi i gabuar i objektit të prokurimit

Rregullat transparente dhe konkurruese të prokurimit do të ishin të kota nëse nuk do të ishte e mundur që të përcaktohej objekti i prokurimit publik në mënyrë të tillë që vetëm një furnizues i veçantë do të jetë në gjendje që të sigurojë furnizimet ose shërbimet e kërkuara. Objekti i prokurimit duhet të përshkruhet në termat e specifikimeve teknike duke siguruar një qasje të barabartë të ofertuesve dhe duke parandaluar krijimin e pengesave të pajustificuara për hapjen e prokurimit publik ndaj konkurrencës. Objekti i kontratës së prokurimit duhet të përshkruhet në mënyrë të qartë duke përdorur formulim mjaft të saktë dhe të plotë si dhe duke marrë në konsideratë të gjitha kërkesat dhe rrethanat që mund të kenë ndikim në përgatitjen e një tenderi.

Autoriteti kontraktor shkel ligjin nëse ai e përshkruan objektin e prokurimit në një mënyrë që mund të kufizojë konkurrencën në mënyrë të padrejtë; në mënyrë të veçantë, ai shkel ligjin kur përshkruan objektin e prokurimit duke iu referuar markës tregtare, patentave ose origjinës, nëse referenca nuk justifikohet nga natyra e objektit të kontratës, ose nëse autoriteti kontraktor nuk mund të përshkruajë ndryshe objektin me saktësi të mjaftueshme, dhe me kusht që një referim i tillë të shoqërohet me fjalët "ose ekuivalent".

Gabimet në lidhje me specifikimet e njëanshme dhe të kopsitura janë ndër më të vështirat për t'u zbuluar. Megjithatë, **operatorët ekonomikë shpesh i sjellin këto gabime në vëmendjen e institucioneve përkatëse duke u ankuar në lidhje me masat që i privojnë ata nga mundësitë për të ofruar punët, furnizimet apo shërbimet e tyre. Për të provuar para autoritetit kontraktor që rregullat e prokurimit janë shkelur mund të jetë e nevojshme që të thirren ekspertë të jashtëm të pavarur në fushën specifike për të shprehur opinionet e tyre.**



**e) Kushtet për pjesëmarrje që nuk përputhen me parimet e trajtimit të barabartë, proporcionalitetit dhe të konkurrencës së vërtetë**

Qëllimi i kushteve të përzgjedhjes (kualifikimit) është të identifikojë ata operatorë ekonomikë që janë të aftë për realizimin dhe përfundimin e kontratës që do të jepet. Autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë kushtet që janë të barabarta për të gjithë operatorët ekonomikë. Kur vendosen kushtet për pjesëmarrje, autoriteti kontraktor mund të caktojë nivelet minimale të kapacitetit që operatorët ekonomikë duhet të plotësojnë, kur kërkohet, duke përfshirë edhe kapacitetet e palëve të treta. Këto kushte duhet të jenë të lidhura dhe në përpjesëtim me objektin e prokurimit. Procesi i përzgjedhjes duhet të kufizohet në vlerësimin e faktit se nëse janë plotësuar apo jo shkaqet e përjashtimit (të detyrueshme ose jo të detyrueshme), si dhe në vlerësimin e përshtatshmërisë së operatorit ekonomik për të kryer shërbime, gjendjen e tij financiare dhe ekonomike, dhe kapacitetin e tij teknik dhe/ose profesional.

Kriteret e mëposhtme të kualifikimit janë konstatuar si të paligjshme nga ana e Gjykatës së Drejtësisë të Bashkimit Evropian (GJED) në kuadër të jurisprudencës së saj:

- Preferenca e dhënë operatorëve ekonomikë që kryejnë aktivitetin e tyre kryesor në rajonin ku do të kryhen punimet që përbëjnë objektin e prokurimit;
- Pjesëmarrja në procedurën e prokurimit të kufizuar në ofertuesit me shumicë kapitali që është në pronësi publike;
- Kërkesa e provës se projektuesi të jetë anëtar i shoqatës së arkitektëve të vendit të autoritetit kontraktor;
- Përjashtimi i ofertuesve nga procedura për të vetmen arsye se ata marrin një subvencion publik;
- Kushti që ofertuesi duhet, në kohën e dorëzimit të ofertës, të ketë një zyrë të hapur për publikun në kryeqytetin e provincës ku do të ofrohet shërbimi.

**Në lidhje me zbatimin e kriterëve të përzgjedhjes mund të bëhen gabimet e mëposhtme:**

- Kriteria diskriminuese lidhur me kualifikimin ose kriteret që shtrembërojnë konkurrencën;

**Rast studimor**

Në një procedurë të prokurimit publik që kishte të bënte me shërbime të mbikëqyrjes në lidhje me ndërtimin e sistemit të kanalizimeve, autoriteti kontraktor kërkoi dëshmi nga operatorët ekonomikë që të provonin se kishin përfituar përvojë në shërbime të ngjashme pas një procedure të prokurimit dhe të financuar nga fondet e ndihmës së jashtme (të tillë si fondet e BE-së, Mekanizmi Financiar Norvegjez, apo Banka Botërore). Kjo kërkesë është vlerësuar si diskriminuese dhe që shtrembëron konkurrencën.

- Kërkesat që nuk janë të lidhura me punët, furnizimet ose shërbimet që përbëjnë objektin e prokurimit dhe/ose kërkesat që janë joproporcionale dhe janë të arritshme vetëm nga një numër i kufizuar operatorësh ekonomikë;

**Raste studimore**

1) Autoriteti kontraktor dha një kontratë për shërbime të mbikëqyrjes në lidhje me ndërtimin e sistemit të kanalizimeve. Vlera e shërbimeve u vlerësua në shumën modeste prej 60 000 Euro dhe risqet e realizimit të kontratës ishin të ulëta. Autoriteti kontraktor kërkoi, në mesin e kushteve të tjera, që operatorët ekonomikë të interesuar në ofrimin e këtyre shërbimeve duhet të kishin një policë sigurimi për një vlerë prej 2,5 milion euro. Përfundimi i inspektorëve që audituan procedurën ishte se autoriteti kontraktor kishte vendosur një kërkesë që ishte disproporcionalisht e lartë.

2) Në një procedurë tjetër, në lidhje me rinovimin e një stacioni hekurudhor, operatorëve ekonomikë iu kërkua që të demonstrojnë përvojën e tyre në lloje të ndryshme të punëve (të

ndërtimit të parkingjeve të makinave, të rrjeteve elektrike, hekurudhave, etj.), që ata **kishin fituar gjatë zbatimit të një projekti të vetëm**. Operatorëve ekonomikë nuk u ishte lejuar që të demonstrojnë aftësitë e tyre teknike në lidhje me llojet e ndryshme të punëve që ata kishin fituar në projekte të veçanta. Inspektorët gjetën këtu gjithashtu se kërkesat lidhur me mënyrën në të cilën mund të demonstrohej kapaciteti teknik, ishin në kundërshtim me ligjin e prokurimit.

- **Kërkesa nga operatorët ekonomikë për dokumentet që janë të parëndësishme për procedurën mospranimit i Dokumentit Unik Evropian të Prokurimit (DUEP):** në përputhje me rregullat e lartpërmendura, autoriteti kontraktor bën gabim, në qoftë se kërkon dokumente që nuk janë të nevojshme në mënyrë që të dëshmohet se operatori ekonomik është i besueshëm dhe i aftë për të kryer kontratën në fjalë, të tilla si dokumentet që nuk kanë lidhje me kërkesat ose kushtet e vendosura nga autoriteti kontraktor. Ai gjithashtu mund të bëjë një gabim në qoftë se nuk arrin të pranojë DUEP-in si provë dhe dëshmi. Për informacion të mëtejshëm mbi DUEP-in shih Udhëzimin nr. 7 të SIGMA-s për Prokurimin publik, *Përzgjedhja e operatorëve ekonomikë*.
- Shkeljet në lidhje me përshkrimin e çështjes së prokurimit publik: shkeljet e tilla mund të rregullohen, nëse ata janë të zbuluar dhe të sfiduar nga operatorët ekonomikë në fillim të mjaftueshme në procedurën e prokurimit. Për të korrigjuar këtë shkelje, ajo do të mjaftonte për të fshirë ose ndryshuar të gjitha kriteret diskriminuese apo kërkesat që nuk janë të lidhura me objektin e prokurimit në dokumentet e tenderit. Përveç kësaj, autoriteti kontraktor ndoshta do të duhet të ndryshojë Njoftimin për kontratë, nëse ky modifikim kishte të bënte me informacionin e përfshirë në Njoftimin për Kontratë.

#### **f) Aplikimi i gabuar i kriterëve të vlerësimit të ofertave (dhënies së kontratës)**

Kriteret e dhënies së kontratës përbëjnë bazën mbi të cilën autoriteti kontraktor zgjedh ofertën më të mirë dhe, rrjedhimisht, jep kontratën. Kriteret e dhënies së kontratës duhet të përcaktohen paraprakisht nga autoriteti kontraktor dhe nuk mund të jenë të dëmshme për konkurrencën e drejtë. Zbatimi i duhur i kriterëve për dhënien e kontratës është vendimtar për procesin e dhënies së kontratave publike - në qoftë se ato nuk zbatohen si duhet, atëherë procesi i tenderit, vlerësimi i ofertave dhe vendimi për dhënien e kontratës mund të jenë me të meta. Kjo mund të ketë kuptimin se procesi i tenderit do të duhet të anulohet për të ri-filluar, pasi përndryshe nuk mund të zgjidhet oferta më e mirë.

Gjatë përcaktimit të kriterëve të dhënies së kontratës, autoriteti kontraktor duhet para së gjithash të respektojë parimin themelor të mosdiskriminimit (sidomos në bazë të kombësisë). Së dyti, kriteret e dhënies së kontratës nuk mund të jenë të dëmshme për konkurrencën e drejtë. Së treti, në përputhje me parimin e transparencës, të gjitha kriteret e dhënies së kontratës (dhe nën-kriteret, nëse autoriteti kontraktor vendos për të ndarë kriteret e vlerësimit në elemente të ndryshme përbërëse) duhet t'i tregohen paraprakisht ofertuesve të mundshëm me anë të dokumenteve të kontratës apo njoftimit të kontratës. Së katërti, kriteret e dhënies së kontratës duhet të formulohen në mënyrë të tillë që t'u mundësojnë të gjithë ofertuesve të mirëinformuar në mënyrë të arsyeshme dhe normalisht të zellshëm që t'i interpretojnë ato në të njëjtën mënyrë. Përfundimisht, autoriteti kontraktor duhet të interpretojë kriteret e dhënies së kontratës në të njëjtën mënyrë në të gjithë procedurën.

Ashtu si në rastin e kriterëve të përzgjedhjes të përshkruara më lart, GJED-ja ka identifikuar në jurisprudencën e saj disa kriteret të dhënies së kontratës që ajo i ka gjetur si të paligjshme:



- Marrja parasysh e një liste të realizimeve të kryera nga ofertuesi në të kaluarën (ky kriter mund të zbatohet vetëm si kriter kualifikimi, pasi ai i referohet kapacitetit, domethënë përvojës së operatorit ekonomik);
- Kërkesa që produkti që është objekt i tenderit, të jetë i disponueshëm për inspektim nga autoriteti kontraktor brenda një rrezeje prej një numri të caktuar kilometrash;
- Kriteri që nuk shoqërohet me kërkesat që mundësojnë verifikimin efektiv të saktësisë së informacionit të dhënë në dosjen e tenderit;
- Kriteri që jep, me pikë shtesë, ekzistencën, *në kohën kur është dorëzuar oferta*, e një impianti që gjendet brenda 1 000 km të kryeqytetit të një krahine apo të zyrave të hapura për publikun në qytete të tjera të specifikuara.

**Autoriteti kontraktor mund të bëjë gabim në zbatimin e kriterëve të dhënies së kontratës në qoftë se ai:**

- Zbaton kriteret që janë në kundërshtim me ligjin e prokurimit, në veçanti me parimet e transparencës dhe trajtimit të barabartë, si për shembull duke lejuar preferencat e çmimeve për kompanitë e vendosura në të njëjtën zonë ku ndodhet edhe autoriteti kontraktor;
- Zbaton kriteret që nuk lejohen në një procedurë të veçantë të prokurimit - për shembull, në dialogun konkurrues autoriteti kontraktor zbaton kriterin e çmimit kur në një rast të tillë, në përputhje me rregullin përkatës, ai duhet të zbatojë raportin më të mirë çmim-cilësi;
- Zbaton kriteret që rrisin pasigurinë për mënyrën se si do të vlerësohen ofertuesit.

#### **Rast studimor**

Në një procedurë prokurimi për dhënien e një kontrate me çelësa në dorë për projektimin, shpërndarjen dhe ndërtimin e një parku eolik, autoriteti kontraktor vendosi si një nga kriteret e vlerësimit "kushtet e ofruara nën garanci", në bazë të "opinionit të ekspertit".

**Shkeljet që kanë të bëjnë me zbatimin e kriterëve për dhënien e kontratës mund të rregullohen me heqjen ose ndryshimin e kriterëve të cilat nuk janë në përputhje me dispozitat përkatëse. Nëse kriteret janë publikuar në njoftimin e kontratës, atëherë do të jetë i nevojshëm publikimi i një korrektimi të njoftimit i ndjekur nga zgjatja e duhur të afatit për pranimin e ofertave.**

Për informacion të mëtejshëm mbi këtë çështje shih Udhëzimin nr. 8 të SIGMA-s për Prokurimin publik, *Vendosja e kriterëve të shpalljes së fituesit*.

## **2. Gabimet që bëhen në kryerjen e procedurës**

### **a) Mosrespektimi i afateve kohore të përcaktuara në rregullat e prokurimit**

Qëllimi i dispozitave që rregullojnë afatet minimale kohore për marrjen e ofertave t'u mundësojnë operatorëve ekonomikë, në veçanti operatorëve të huaj, që të përgatisin dhe të dorëzojnë ofertat që përmbushin kërkesat e autoritetit kontraktor.

Në rrjedhën e procedurës së prokurimit mund të ndodhin parregullsitë e mëposhtme:

- Afatet kohore qenë shumë të shkurtra për pranimin e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje, veçanërisht nëse ato janë më të shkurtra se afatet kohore minimale të kërkuara nga ligji i prokurimit;
- Pranimi i procedurës dhe vlerësimi i ofertave të pranuar pas afatit: ofertat e tilla duhet t'i kthehen të pahapura ofertuesit në fjalë, përveçse nëse paraqitja me vonesë është rezultat i një defekti të autoritetit kontraktor (për shembull, tregimi në mënyrë të gabuar i vendit të pranimit të ofertave, ose një mosfunksionim i sistemit të TIK-ut, që ka bërë të pamundur

paraqitjen e ofertat elektronike në kohë). Në përgjithësi, pranimi në procedurë i ofertave të marra pas afatit është i barasvlershëm me shkeljen e parimit të trajtimit të barabartë;

- Shkeljet në lidhje me zbatimin e dispozitave që kanë të bëjnë me afatet kohore: shkeljet e tilla mund të rregullohen në procesin e prokurimit; zgjatja e duhur (në përputhje me ligj) e afateve të caktuara dhe njoftimi për këtë fakt i të gjithë operatorëve ekonomikë në fjalë normalisht do të mjaftonte.

**b) Vlerësimi i gabuar i kualifikimeve të operatorëve ekonomikë, duke rezultuar në skualifikimin e tyre**

Kur autoriteti kontraktor vlerëson ofertat e dorëzuara apo kërkesat për pjesëmarrje, ai duhet të kontrollojë nëse ofertuesit ose kandidatët duhet të përjashtohen dhe pastaj të vazhdojnë për të parë nëse ata i plotësojnë apo jo kriteret që lidhen me kualifikimin e tyre (përzgjedhjen). Prandaj, në këtë mënyrë ndodh një parregullsi, kur autoriteti kontraktor gabimisht skualifikon një operator ekonomik që në fakt plotëson të gjitha kërkesat, ose, në të kundërtën, kur autoriteti kontraktor pranon në procedurë një operator ekonomik që duhet të përjashtohet ose që nuk duhet të ftohet për të dorëzuar ofertë. Kjo çështje është e lidhur ngushtë me interpretimin e duhur të dokumenteve të paraqitura nga pjesëmarrësit (këto dokumente ose deklarata mund të mungojnë, mund të jenë të paplota ose të paqarta). Nëse ka dyshim, autoriteti kontraktor duhet të kërkojë sqarime nga ofertuesit (kandidatët) në fjalë, por duke respektuar parimin e trajtimit të barabartë (të gjithë pjesëmarrësit në të njëjtën situatë duhet të trajtohen në të njëjtën mënyrë).

**c) Vlerësimi i gabuar i ofertave që rezultojnë në refuzimin e një oferte që është në përputhje rregullat ose mos-refuzimin e një oferte që nuk është në përputhje rregullat**

Ofertat duhet të vlerësohen në përputhje me kërkesat e përcaktuara në specifikimet teknike që janë dhënë në njoftimin e kontratës ose në dokumentet e tenderit. Ofertat që në thelb nuk janë në përputhje me kërkesat, duhet të refuzohen. Nëse autoriteti kontraktor i lejon ofertuesit në fjalë që t'i korrigjojnë ato oferta, atëherë kjo do të ishte në kundërshtim me parimin e trajtimit të barabartë. Nga ana tjetër, ofertat që nuk janë në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor, të cilat nuk përbëjnë kërkesa themelore, nuk duhet të hidhen poshtë menjëherë.

**Shkeljet që kanë të bëjnë me vlerësimin e ofertave mund të rregullohen me anë të përsëritjes së procesit të vlerësimit të ndjekur nga një përzgjedhja e ofertës më të mirë.**

**d) Modifikimi i kriterëve të dhënies së kontratës në rrjedhën e procesit të prokurimit**

Kriteret e publikuara në njoftimin e kontratës (dosjen e tenderit) në përgjithësi duhet të jenë kriteret e zbatuara. Megjithatë, gjatë procesit të tenderit, autoriteti kontraktor mund dhe duhet të marrë parasysh rrethanat e reja që kanë ndikim në kriteret e shpallura të dhënies së kontratës, ose ai mund të ketë nevojë të korrigjojë një mosveprim ose gabim. Ndryshimet në kriteret e dhënies mund të ndahen në ndryshime materiale dhe në ndryshime jo materiale. Ndryshimi është material kur ka të ngjarë që të ketë pasoja për identitetin e operatorëve ekonomikë që do të marrin pjesë në procesin e tenderimit. Përgjithësisht, kur ndodh një ndryshim që është material, është e nevojshme që të bëhet kthimi në fazën në të cilën është bërë ndryshimi. Për shembull, një ndryshim në lidhje me aplikimin e ofertës ekonomikisht më të favorshme në vend të kriterit të çmimit më të ulët është ndryshim material që ka të bëjë me një nga elementet që sigurojnë bazën mbi të cilën operatorët ekonomikë vendosin nëse ata do të marrin pjesë ose jo në procedurën e prokurimit. Për më tepër, ndryshimi ka të bëjë me një element që duhet të ishte shpalosur në njoftimin e kontratës. Ndryshimi jo material, nga ana tjetër, lejohet në parim. Në këtë rast, në përgjithësi do të mjaftonte një korrigjim i njoftimit të Kontratës dhe/ose i dokumenteve të kontratës, gjë e cila duhet të shoqërohet me një zgjatje të përshtatshme dhe shpallje në mënyrë të rregullt të afatit për paraqitjen e ofertave. Përcaktimi nëse një ndryshim është material ose jo material, duhet të marrë parasysh rrethanat specifike të secilit rast. Në asnjë rrethanë nuk mund të ndryshohen ose të hiqen gjatë procesit të vlerësimit të ofertave kriteret e shpallura të dhënies së kontratës (duke përfshirë edhe

peshën relative të kritereve të ndryshme, zbatimin e çdo nënkriteri dhe peshën e tyre relative, dhe një metodologji më të detajuar të vlerësimit). Në këtë fazë, të gjitha kriteret (dhe nënkriteret) duhet të zbatohen ashtu siç janë.

**Nëse autoriteti kontraktor dëshiron të ndryshojë kriteret e dhënies së kontratës në mënyrë të tillë që ndryshimi do të përbënte një ndryshim material siç përcaktohet më sipër, atëherë ky ndryshim zakonisht kërkon shpalljen e njoftimit të dytë të kontratës dhe zgjatjen e duhur të afatit kohor për dorëzimin e ofertave. Nga ana tjetër, nëse autoriteti kontraktor ndryshon kriteret e dhënies së kontratës sapo të ketë kaluar afati për dorëzimin e ofertave, atëherë një shkelje e tillë do të mund të rregullohet vetëm me anulimin e të gjithë procedurës dhe me ripublikimin e saj.**

#### **e) Anulimi i procedurës pa një arsye të vlefshme**

Procedurat e prokurimit publik, në mënyrë të veçantë ato që nisen me një thirrje publike për konkurrim, nuk duhet të anulohet pa arsye. Arsyeja për këtë rregull është se operatorët ekonomikë të interesuar që i përgjigjen një mundësie të tenderimit dhe marrin pjesë në procesin e prokurimit, investojnë kohë dhe burime në përgatitjen e ofertave të tyre, të cilat nuk mund të konsiderohen si të papërfillshme. Rregullat e prokurimit publik në përgjithësi lejojnë anulimin e procedurës për arsye të rëndësishme, të paparashikuara, në veçanti nëse dhënia e kontratës, për shkak të një ndryshimi të papritur të rrethanave, nuk është më në interes të publikut. Nevoja për anulimin e kontratës mund të jetë rezultat i veprimeve të paligjshme të ofertuesve, për shembull në qoftë se rezultoni se ata kanë vepruar në bashkëpunim. Mund të ndodhë gjithashtu që anulimi i procedurës është i nevojshëm për të korrigjuar një procedurë që është me të meta në mënyrë të tillë që parregullsitë e shkaktuara nga autoriteti kontraktor nuk mund të hiqen ndryshe. Për shembull, në qoftë se nuk është botuar ftesë për konkurrim, në kundërshtim me rregullat e prokurimit, si dhe autoriteti kontraktor është vënë në dijeni për këtë shkelje, atëherë do të ishte e preferueshme që procedura të ndërpritej në vend që të vazhdonte më tej me lidhjen e kontratës, e cila më pas mund të deklarohet e pavlefshme nga një gjykatë ose një organ i pavarur shqyrtues.

Vendimi i autoritetit kontraktor për të anuluar procedurën e tenderit duhet të jetë i justifikuar plotësisht, sidomos kur anulimi është për shkak të një ndryshimi të rrethanave në bazë të së cilave është shpallur procedura e tenderit apo për arsye të tjera të paparashikuara.

**Anulimi i pabazuar (përfundimi) i procedurës së kontratës mund të rregullohet me anë të anulimit të vendimit për ndërprerjen e procedurës dhe dhënien e kontratës përkatëse.**

#### **f) Gabime të tjera që ndodhin në rrjedhën e procedurës**

- **Aplikimi i gabuar i rregullave të komunikimit** - për shembull, autoriteti kontraktor nuk i informon të gjithë pjesëmarrësit për vendimeve specifike të marra në rrjedhën e procedurës.
- **Mospublikimi** i një Shtojce të Njoftimit të Kontratës në një situatë ku ka pasur një ndryshim të procedurës lidhur me elementet e publikuara në Njoftimin e Kontratës - për shembull, autoriteti kontraktor zgjat afatin kohor për pranimin e aplikimeve apo të ofertave, por nuk publikon një njoftim në lidhje me ndryshimin.
- Pjesëmarrja, në emër të autoritetit kontraktor, e një personi i cili është në konflikt interesi - për shembull, personi ka lidhje ose ka qenë i punësuar nga operatori ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit. Në përputhje me parimin e paanshmërisë, pasi janë hapur kërkesat për pjesëmarrje apo ofertat, të gjithë anëtarët e komisionit të tenderit duhet të deklarojnë çdo konflikt të mundshëm interesi; ata duhet të përjashtohen nga puna e mëtejshme e komisionit të tenderit dhe nuk duhet të kenë rol në zgjedhjen e ofertës më të mirë. Kjo është shkelje shumë e madhe, pasi ajo mund të ketë ndikim mbi rezultatet e procesit të prokurimit. Neni 24 i Direktivës përmban dispozita specifike që kërkojnë që autoritetet kontraktore të marrin masa efektive për parandalimin,

identifikimin dhe korrigjimin e konfliktit të interesit gjatë ushtrimit të procedurave të prokurimit.

**Në mënyrë që të vendoset nëse të anulohet apo jo e gjithë procedura e prokurimit ose të korrigojen shkeljet e përmendura më lart, duhet të analizohet rasti specifik dhe duhet të vlerësohet ndikimi i gabimit në rezultatet e procedurës.**

### **3. Gabimet që bëhen pas zgjedhjes së ofertës më të mirë apo lidhjes së kontratës së prokurimit**

Rregullat e prokurimit publik, duke përfshirë edhe direktivat e BE-së, vendosin disa kërkesa që duhet të plotësohen nga autoriteti kontraktor edhe pasi të ketë mbaruar procedura e dhënies së kontratës. Disa nga parregullsitë e renditura më poshtë mund të cilësohen në përgjithësi si parregullsi të rëndësishme, ndërsa të tjerat, në varësi të rrethanave të veçanta, mund edhe të mos cilësohen si thelbësore.

#### **a) Mosrespektimi i periudhës së pritjes së ankesave**

Autoritetet kontraktore duhet të presin për një numër të caktuar ditësh ndërmjet vendimit për dhënien e kontratës dhe lidhjes së kontratës me ofertuesin e suksesshëm. Kjo "periudhë e ankesave" u mundëson ofertuesve, ofertat e të cilëve nuk janë përzgjedhur, që të kundërshtojnë vendimin e autoritetit kontraktor dhe, për këtë arsye, të parandalojnë dhënien e kontratës në bazë të një vendimi të gabuar. Autoriteti kontraktor që nuk respekton afatin e pritjes së ankesave (domethënë hyn në një kontratë para skadimit të periudhës së ankesave) shkel rregullat e prokurimit. Sipas rregullave të BE-së, kjo shkelje trajtohet si një shkelje e rëndësishme dhe duhet të rezultojë në deklarimin e kontratës si të pavlefshme, me kusht që shkelja t'i ketë hequr ofertuesit që ka aplikuar për shqyrtim, mundësinë që ai të ndiqte mjetet juridike para-kontraktuale dhe me kusht që kjo të jetë kombinuar me një shkelje të rregullave procedurale të sektorit publik. Me fjalë të tjera, vetëm shkelja e rregullave të periudhës së pritjes së ankesave nuk është e mjaftueshme që të rezultojë në kërkesën për ta deklaruar kontratën të pavlefshme. **Kontrata duhet të shpallet e pavlefshme vetëm nëse shkelja e rregullave të pritjes së ankesave shoqërohet me një shkelje të rregullave të tjera të prokurimit publik (për shembull, zgjedhja e një oferte që nuk është në përputhje me rregullat ose e një oferte që nuk ishte më e mira), dhe ofertuesi i dëmtuar (ofertuesit të cilit nuk ia kanë përzgjedhur ofertën e tij në kundërshtim me dispozitat ligjore) nuk ka mundësi të kundërshtojë vendimin e autoritetit kontraktor dhe, rrjedhimisht, nuk ka një mundësi që të fitojë kontratën.**

**Nëse kontrata është lidhur para skadimit të afatit të pritjes së ankesave, atëherë ky gabim mund të rregullohet nga autoriteti kontraktor vetëm duke e deklaruar kontratën të pavlefshme. Megjithatë, fakti nëse është e nevojshme apo jo që të anulohet kontrata varet nëse kjo shkelje e plotëson kushtin e treguar më sipër apo jo.**

#### **b) Mosinformimi i pjesëmarrësve në procedurë për rezultatet e saj**

Pasi të merret një vendim në lidhje me përzgjedhjen e ofertës fituese, autoriteti kontraktor është i detyruar të njoftojë të gjithë operatorët ekonomikë në fjalë për rezultatet e procedurës. Ky detyrim synon të pajisë pjesëmarrësit në procedurë me mundësinë për të kundërshtuar vendimin e autoritetit kontraktor nëse ata mendojnë se kjo është e gabuar. Sipas Direktivës së Mjeteve Juridike, autoriteti kontraktor është i detyruar që të komunikojë vendimin e dhënies së kontratës për çdo tenderues dhe kandidat në fjalë, duke iu ofruar atyre një përmbledhje të arsyeve përkatëse për zgjedhjen e një oferte ndaj të tjerave dhe me një deklaratë të saktë në lidhje me periudhën e zbatueshme të pritjes së ankesave. Moskomunikimi i rezultateve të procedurës është një shkelje e rëndë e rregullave të prokurimit, pasi ajo e bën hipotetike mundësinë e ankimit kundër një vendimi të autoritetit kontraktor, në veçanti nëse kjo parregullsi shoqërohet me mosrespektimin e rregullave të periudhës së pritjes së ankesave. Megjithatë, nëse kjo parregullsi ka ndikim apo jo në rezultatet e procedurës, kjo varet nga rrethanat e veçanta të rastit.

Ky lloj mosveprimi mund të rregullohet duke kryer veprimin e kërkuar (domethënë, njoftimin e pjesëmarrësve për rezultatet e procedurës). Në fakt, është në interes të autoritetit kontraktor që t'i informojë pjesëmarrësit për rezultatet e procedurës, pasi afati kohor për dorëzimin e kërkesave për shqyrtim (ankesave) llogaritet nga momenti që informacioni është dërguar ose pranuar nga (në varësi në ligjin në fuqi) operatorët ekonomikë në fjalë.

**c) *Mospublikimi i njoftimit për dhënien e kontratës***

Rregullat e BE kërkojnë nga autoriteti kontraktor që ai të komunikojë vendimin për dhënien (lidhjen) e kontratës publike duke publikuar njoftimin e kontratës në GZBE. Kjo kërkesë është e përcaktuar edhe në të drejtën kombëtare për prokurimin publik. Njoftimi zakonisht duhet të bëhet menjëherë dhe jo më vonë se një numër i caktuar ditësh pas lidhjes së kontratës. Meqenëse ky njoftim nuk është pjesë e procedurës së prokurimit (që mbaron me vendimit për dhënien e kontratës për një ofertues të veçantë), atëherë autoritetet kontraktore shpesh e injorojnë këtë kërkesë. Megjithatë, kjo kërkesë është një element që rrit transparencën, dhe rëndësia e saj nuk mund të mohohet, edhe pse ndikimi i saj në funksionimin e sistemit të prokurimit nuk është e njëjtë siç mund të jetë, për shembull, mospublikimi i Njoftimit të Kontratës.

Ky lloj gabimi mund të rregullohet lehtë me anë të publikimit të njoftimit të kërkuar. Është në interes të autoritetit kontraktor që të publikojë një njoftim të tillë, pasi periudha (më e shkurtër) për shqyrtim fillon me publikimin e njoftimit.

**d) *Publikimi i informacionit jo të plotë në Njoftimin e Dhënies së Kontratës ose publikimi pas afatit të kërkuar kohor***

Autoriteti kontraktor mund të bëjë një gabim kur ai boton Njoftim për Dhënien e Kontratës në mënyrë të tillë që komunikimi i këtij informacioni vonohet (njoftimi publikohet, por më vonë se sa kërkohet me ligj) ose nuk përmban të gjithë informacionin e kërkuar. Në të dyja rastet, ky gabim çon në një shkëlqje të rregullave të transparencës, pasi ai pengon operatorët ekonomikë, institucionet publike - duke përfshirë organet e auditimit ose të monitorimit - si dhe publikun nga kryerja e funksioneve monitoruese. Autoriteti kontraktor mund të mos japë informacion, për shembull, për identitetin e operatorit të përzgjedhur ekonomik, arsyet për zgjedhjen e kësaj oferte, numrin e ofertave të dorëzuara dhe të refuzuara, çmimin më të ulët të paraqitur dhe as çmimin e ofertës fituese. Edhe pse kjo është një shkëlqje e rregullave të prokurimit, zakonisht kjo nuk do të ketë ndikim mbi rezultatet e procedurës së përfunduar të prokurimit, në veçanti nëse procedura ka qenë transparente dhe konkurruese, dhe si e tillë, shkëlqja është më shumë formale se sa substanciale. Është e mundshme që rezultatet e procedurës do të kishin qenë të njëjta nëse autoriteti kontraktor do të kishte vepruar në përputhje të plotë me kërkesat e publikimit. Kjo nuk ndodh kur publikimi i Njoftimit të Kontratës ndjek një procedurë që nuk është transparente apo konkurruese, të tillë si procedura me negociim pa shpallje paraprake të ftesës për konkurrim. Ky lloj njoftimi duhet të përmbajë informacion mbi arsyet për zbatimin e kësaj procedure (baza ligjore që justifikon mungesën e konkurrencës). Mosdhënia e këtij informacioni nuk do të thotë se ligji është shkelur, por kjo duhet të tërheqë vëmendjen e organeve përkatëse lidhur me zbatimin e duhur të përjashtimit nga parimet e përgjithshme.

**e) *Lidhja e një kontrate që është në kundërshtim me kushtet e parashikuara në ofertën fituese***

Autoriteti kontraktor duhet të lidhë kontratë me ofertuesin fitues në përputhje me termat dhe kushtet e ofertës të ofertuesit. Me fjalë të tjera, kushtet e kontratës së lidhur duhet të pasqyrojnë angazhimet e marra në ofertën që është përzgjedhur si oferta më e mirë. Autoriteti kontraktor do të shkelë parimin e trajtimit të barabartë në qoftë se ai e lejon që ofertuesi fitues të paguhet më tepër apo që të realizojë një kontratë me kushte që janë më të favorshme për ofertuesin. Nga ana tjetër, ndryshimi i kontratës ndryshe nga oferta lejohet përjashtimisht në raste të justifikuara në mënyrë rigorozë, nëse kjo rezulton nga rrethana që nuk mund të parashikoheshin kur është zgjedhur oferta më e mirë ose në rrethana të tjera të përshkruara në mënyrë të përpiktë. Megjithatë, këto

ndryshime nuk duhet të kenë të bëjnë me angazhimet e operatorit ekonomik të përfshira në ofertë, e cila është vlerësuar me anë të procedurës së prokurimit.

**f) Modifikimi i një kontrate gjatë zbatimit të saj në kundërshtim me rregullat që lejojnë një modifikim të tillë**

Pasi kontrata të jetë lidhur me ofertuesin fitues, ajo duhet të zbatohet ashtu siç është dhe nuk mund të ndryshohet përveç se në raste të veçanta, për shembull, nëse nevoja për ndryshim rezulton nga ngjarje të paparashikuara. Në përgjithësi, **ndryshimi thelbësor i kontratës është i ndaluar**. Është e kuptueshme që ky rregull i përgjithshëm zbatohet në ndryshimet që e bëjnë kontratën thelbësisht të ndryshëm nga ajo që është lidhur në fillim. Për shembull, një modifikim i tillë:

- Do të ndryshojë ekuilibrin ekonomik të kontratës në favor të kontraktorit;
- Do të përfshijnë furnizimet, shërbimet apo punët që nuk ishin pjesë e procesit fillestar të prokurimit;
- Do të rezultojë, nëse është zbatuar tashmë në procesin e prokurimit, në përzgjedhjen e një operatori tjetër ekonomik ose në dhënien e kontratës një tjetër ofertuesi.

Ndalohen modifikimet e rëndësishme të kontratave nëse nuk ato zbatohen me anë të një procesi të prokurimit të ri (transparent dhe konkurrues), me anë të një thirrje të re për konkurrim.

Nga ana tjetër, ndryshimet në kontratë nuk perceptohen si të rëndësishme në qoftë se:

- Ato kanë të bëjnë me ato elemente të kontratës që nuk ndryshojnë natyrën e përgjithshme të kontratës;
- Ato janë parashikuar në dokumentet e prokurimit lidhur me procedurën origjinale të prokurimit në dispozitat ose opsionet e qarta, të sakta dhe pa ekuivoke të shqyrtimit; dispozitat apo opsionet e tilla duhet të specifikojnë qëllimin dhe natyrën e modifikimeve të mundshme, si dhe kushtet në të cilat mund të ushtrohen këto ndryshime.

Modifikimet thelbësore të kontratave të cilat zbatohen pavarësisht nga kufizimet e lartpërmendura përbëjnë parregullsi serioze në procesin e prokurimit publik.

**Modifikimi i rëndësishëm i kontratës në kundërshtim me rregullat përkatëse mund të rregullohet vetëm duke deklaruar modifikimin e kontratës si të pavlefshëm.**

**g) Dhënia e shërbimeve ose punëve shtesë pa aplikimin e procedurave konkurruese dhe transparente**

Legjislacioni i BE-së dhe ligjet kombëtare që zbatojnë legjislacionin e BE-së lejojnë, në kushte të caktuara, dhënien e kontratës pa shpalljen paraprake të një ftese për ofertë. Raste të tilla përfshijnë dhënien e punëve ose shërbimeve shtesë për operatorin ekonomik që ka qenë palë në kontratën origjinale ose dhënia e një kontrate të përbërë nga punë ose shërbime të reja që përbëjnë një përsëritje të shërbimeve ose punëve që janë të përfshira në procesin fillestar të prokurimit. Si përjashtim nga parimet e përgjithshme të transparencës dhe konkurrencës, ky opsion mund të përdoret në kushte të përcaktuara në mënyrë rigorozë (që kanë të bëjnë, për shembull, me vlerën e punëve ose shërbimeve shtesë ose të reja ose me periudhën kohore gjatë së cilës ky opsion mund të ushtrohet). Shkelja e rregullave të prokurimit ndodh nëse autoriteti kontraktor i jep shërbimet ose punët e tilla, kur këto kushte nuk janë përmbushur.

**Lidhja e kontratave që kanë të bënë me shërbimet ose punët shtesë në një mënyrë që është në kundërshtim me dispozitat përkatëse përbën një dhënie të paligjshme të kontratës. Ky lloj kontrate (ose kontratash) duhet të deklarohet i pavlefshëm, siç është diskutuar në pikat 1 a) dhe 1 b) më sipër.**



## Informacion i mëtejshëm

### Botimet e SIGMA-s

#### Udhëzimet e Prokurimit Publik

<http://www.sigmaweb.org/publications/key-public-procurement-publications.htm>

SIGMA (2016), *Të kuptuari e kufijve financiarë të BE-së*, Udhëzimi 5, Botimet e OECD-së, Paris

SIGMA (2016), *Përzgjedhja e operatorëve ekonomik*, Udhëzimi 7, Botimet e OECD-së, Paris

SIGMA (2016), *Vendosja e kritereve të shpalljes së fituesit*, Udhëzimi 8, Botimet e OECD-së, Paris

SIGMA (2016), *Procedurat e prokurimit publik*, Udhëzimi 10, Botimet e OECD-së, Paris